



UNMIK



IPVQ

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË**  
**INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU**  
**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO**

**QEVERIA E KOSOVËS**  
**Ministria e Shëndetësisë**

**GOVERNMENT OF KOSOVO**  
**Ministry of Health**

**VLADA KOSOVA**  
**Ministarstvo zdravstva**

### Udhëzim Administrativ (shëndetësi) 17/2006

#### Implementimi i kontratës kolektive sektoriale në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Punëtorëve Shëndetësor të Kosovës

Ministria e Shëndetësisë,

1. Bazuar në autorizimet e dhëna Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) me Regulloren No. 2002/5 të datës 4 Mars 2002, posaqërisht paragrafi (vi) që e autorizon Ministrinë e Shëndetësisë, për ta zhvilluar politikën dhe të zbatojë legjislacionin për një sistem jodiskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor dhe me paragrafin (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendojë ofrimin e aktiviteteve në sektorin e Shëndetësisë në mënyrë që ta përparojë zhvillimin koherent të politikës së mbrojtjes shëndetësore;
2. Bazuar në Nenin 6 të Rregullores së UNMIK, Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë;
3. Bazuar në Nenin tre (3) të Kontratës së Përgjithsme Kolektive, në mes Qeverisë së Kosovës, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Kosovës, i cili u mundëson Federatave Sindikale të lidhin Kontratë të posaçme me Ministrinë përkatëse;
4. Bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale (Shëndetësi) në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, datës 14.10.2005;
5. Me qëllim të implementimit të kësaj Kontrate nga të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës;

<b>Adresa Postare / Postal Address / Poštanska Adresa</b> Ministria e Shëndetësisë/ Rr. Zagrebit p.n., Prishtinë Ministry of Health, Zagreb Street nn. Pristine Ministravstvo Zdravstva, Ul. Zagrebska.b.b, Priština	<b>Telephone:</b> + 381 38 212 227 + 381 38 212 222	<b>Fax:</b> +381 38 212 233
---	---	--------------------------------



Ministria e Shëndetësisë, nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Implementimi i kontratës kolektive sektoriale në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës.

**I. Veprimet e Institucioneve Shëndetësore dhe përfaqësuesve të Sindikatës sipas Neneve të Kontratës:**

1. **Neni 4.** M e rastin e fillimt të procedurës për ndërprerjen e Kontratës së Mardhënjes së punës duhet të njoftohet përfaqësuesi i FSSHK.
2. **Neni 5.** Në Komisionet intervistuese, Zyrat e Personelit të Institucioneve Shëndetësore duhet të dërgojnë ftesë përfaqësuesit të FSSHK, për pjesëmarrje në panelin intervistues në cilësinë e vëzhguesit.
3. **Neni 8.** Institucionet Shëndetësore duhet të sigurojnë implementimin e Programeve për Zhvillim dhe Edukim të Vazhdueshëm Profesional, të pranuar nga Bordi Qendror për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional.
4. **Neni 10.** a) Institucionet duhet të përcaktojnë qartë Punën e natës; b) Institucionet duhet të përpilojnë listat e punëtorëve që kryejnë punët në turnin e natës; c) Institucionet duhet të përpilojnë orarin e kujdestarive, si dhe të paguajnë kompensimin për to konform rregulloreve të MSH dhe MEF.
5. **Neni 12.** a) Institucionet detyrohen të paguajnë VETËM tre muajt e parë të pushimit të lehonisë, pagë të plotë; b) Pas kësaj ata duhet ti drejtojnë punëtorët e tyre që të kërkojnë kompensim nga Fondi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
6. **Neni 14.** a) Institucionet detyrohen që së bashku me përfaqësues të Sindikatës të përpilojnë një Program lidhur me mbrojtjen në punë; b) Dokument bazë për këtë do të shërbejë Doracak i Veprimit për ISH, përpiluar nga MSH.
7. **Neni 15.** a) Të gjitha Institucionet duhet të dëshmojnë se kanë siguruar lokale pune të pajisura me mjete të nevojshme pune për përfaqësues të FSSHK, siç është e cekur në kontratë; b) Udhëheqësve të përmendur në Nenin 15 u arsyetohen mungesat nga puna për ditët e përcaktuara në kontratë; c) Përfaqësuesit e Sindikatave obligohen të sjellin dëshmitë e duhura për mungesën nga puna.
8. **Neni 16.**
  - a) Institucionet dhe FSSHK duhet të propozojnë MSH listat e vendeve të punës me kushte specifike dhe aso që rrezikojnë shëndetin e punëtorëve;
  - b) Ministria duhet të vendosë për kategorizimin e atyre vendeve të punës me kushte specifike dhe të rrezikshme;
  - c) Institucionet duhet të përpilojnë listat e punëtorëve që punojnë nën pikat a) dhe b);
  - d) Institucionet duhet të bëjnë para llogaritjen e implikimeve financiare;
  - e) Institucionet bazuar në limitet e përcaktuara buxhetore duhet të propozojnë gradimin e rri në Buxhetin për vitin vijues;
  - f) Përmbushja e obligimeve financiare nga Neni 16, duhet të bëhet duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit mbi të Hyrat Vetanake, nënshkruar nga MSH dhe MEF.
  - g). Në rast të mungesës së mjeteve financiare, a Institucionet dhe përfaqësuesit e



<b>Adresa Postare / Postal Address / Poštanska Adresa</b> Ministria e Shëndetësisë/ Rr. Zagrebit p.n., Prishtinë Ministry of Health, Zagreb Street nn. Pristina Ministravstvo Zdravstva, Ul. Zagrebska.b.b, Priština	<b>Telephone:</b> + 381 38 212 113	<b>Fax:</b> +381 38 212 233
---	---------------------------------------	--------------------------------

Sindikatës duhet të përcaktojnë prioritetet, për shpenzimin e mjeteve. Kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente duke involvuar numër sa më të madh të punëtorëve.

9. **Neni 17.** Institucionet duhet të bëjnë transparente për të gjithë punëtorët nivelin e arkëtimit të hyrave vetanake dhe mjeteve të grumbulluara nga participimi.
10. **Neni 18.** Institucionet obligohen që të inkorporojnë në trupat e përmendura në këtë nen, përfaqësuesit e Sindikatave.
11. **Neni 19.** a) Institucionet dhe përfaqësuesit e Sindikatave obligohen që në afat prej dy javësh (14 ditë) nga marrja e këtij UA, të formojnë Komisionin Implementues të kontratës; b) Anëtarët e Komisionit duhet të përcaktojnë orarin e takimeve dhe agjendën e punës.

## II. Dispozita kalimtare

### A. Mbikëqyrja e Implementimit të këtij UA.

1. Mbikëqyrjen e këtij UA do ta bëjnë edhe Komisionet e përbashkëta tët MSH dhe FSSHK.
2. Çdo shkelle e këtij UA duhet të raportohet me kohë nga anëtarët e Komisioneve nga pika paraprake;
3. Nenet nga Kontrata Kolektive sektoriale që nuk janë të përfshira në këtë UA duhet të implementohen sipas Kontratës

Ky Udhëzim hyn në fuqi me nënshkrimin nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Prishtinë, 24/10/2006



<b>Adresa Postare / Postal Address / Poštanska Adresa</b> Ministria e Shëndetësisë/ Rr. Zagrebit p.n., Prishtinë Ministry of Health, Zagreb Street nn. Pristine Ministrawstvo Zdravstva, Ul. Zagrebska.b.b, Priština	<b>Telephone:</b> + 381 38 212 113	<b>Fax:</b> +381 38 212 233
---	---------------------------------------	--------------------------------